



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.6482 Prot.

Lezhë, më 06.06.2023

**SHPLLJE PËR VEND TË LIRË PUNË  
SPECIALIST “KORDINATOR LOKAL PËR TURIZMIN PËR PROJEKTIN  
“NDËRLIDHJA E TURIZMIT PËRMES TRASHËGIMISË KULTURORE DHE  
ZGJIDHJEVE INTELIGJENTE NË LEZHË DHE GJAKOVË”**

**LLOJI I DIPLOMËS SHKENCA SHOQËRORE/HUMANE  
NIVELI MINIMAL I DIPLOMËS MASTER SHKENCOR**

Bazuar në ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Kontratës së Grantit 2022/432-185 “Ndërlidhja e Turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”, Marrëveshjes së Partneritetit, Bashkia Lezhë njofton për shpalljen për vend të lirë punë në pozicionin:

- **Specialist “Kordinator lokal për Turizmin për Projektin “Ndërlidhja e Turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, në Bashkinë Lezhë.**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

- Koordinon, mbështet dhe siguron që të gjitha aktivitetet të zbatohen në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kontratën e Grantit;
- Të kontribojë në zhvillimin e projektit dhe të ndihmojë në mënyrë aktive në zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve;

- Në bashkëpunim të ngushtë me Menaxherin e Projektit, koordinon punën dhe aktivitetet më të gjithë partnerët;
- Inicion dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet e projektit;
- Monitorimi dhe ndjekja e afatit kohor të projektit dhe ndjekja e projekteve deri në përfundimin të tij;
- Harton raporte të kërkuara nga dispozitat e kontratës së grantit, që përfshijnë një pjesë narrative dhe një pjesë financiare, në Autoritetin Kontraktor brenda periudhës së përcaktuar në kontratën e grantit;
- Mbikëqyrë aktivitetet e Projektit në Lezhë, rezultatet në kohë dhe do të përgatisë raportet për Bashkinë Lezhë në periudha tremujore;
- Të monitorojë që operacioni të zbatohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në Kontratën e Grantit;
- Paraqet kërkesat për pagesë në AK;
- Ti përgjigjet çdo kërkesë për informacion dhe modifikim të informacionit nga AK;
- Të informojë të gjithë bashk-përfituesit për të gjitha komunikimet që ndodhin me AK-në;
- Të hartojë informime e relacione për Kryetarin e Bashkisë mbi ecurinë e zbatimit të Projektit;
- Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprorët, në lidhje me projektin.

## Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor, e noterizuar);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Dëshminë e Penalitetit;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqërore/Humane. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- Duhet të jenë njohës të mirë të gjuhës angleze.
- Duhet të kenë dy vite pune eksperiencë në fushën e projekteve.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.06.2023.***

## **Rezultatet për fazën e verifikimit**

Në datën **19.06.2023** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

**KRYETARI  
Pjerin Ndreu**